



RAPORT VJETOR 2021-2022

A. PËRSHKRIM I NJSBCZHK.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është njësi e ngritur në nivel universiteti. Përbërja dhe funksionimi i kësaj njësie është miratuar nga Rektori. Mënyra e funksionimit të NJSBCZHK rregullohet me rregullore të veçantë.

Kjo njësi përbëhet nga 10 anëtarë: drejtuesja e zyrës, anëtarë të tjerë të kësaj zyre që janë përzgjedhur nga pedagogët e çdo departamenti, përfaqësues nga administrata, si dhe një përfaqësues nga Këshilli i Studentor.

Kjo njësi është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe ruajtjen e standarteve në UMSH, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri, strategjisë për zhvillim, politikave dhe akteve rregullatore të institucionit. NJSBCZHK përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, dhe shumë proceseve të tjera të vazhdueshëm monitoron, vlerëson, ruan dhe përmirëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara.

NJSBCZHK vlerëson në mënyrë periodike efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore ose artistike, si dhe efikasitetin e veprimtarive administrative të institucionit.

Secili anëtar i NJSBCZHK përgatit raportin e vlerësimit për veprimtarinë e monitoruar dhe mban përgjegjësi të plotë deri në dorëzim të raportit me shkrim dhe të firmosur në dosjen e njësisë.

NJSBCZHK-ja ka autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit.

Të gjitha rezultatet e planveprimit të NJSBCZHK publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit të UMSH.

Në varësi të vlerësimit dhe monitorimit, çdo raportim që lidhet me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Drejtuesëve të Njesisë Bazë.

Raporti vjetor i njësisë dhe tërësia e veprimtarisë (dokumenta, raporte, etj) dorëzohet tek Rektori në fund të vitit akademik.

B. Metodologjia e punës dhe planveprimi për vitin akademik 2021-2022

Metodologjia e punës së kësaj njësie është e bazuar në: Rregulloren e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, manualin e saj, Ligjin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.80/2015; Date 22.07.2015; Neni 103 dhe 104, Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë; Nenin 53 dhe 84 dhe në rregulloren e UMSH neni 28, si dhe të gjitha dokumentet e ASCAL-it.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka në vëmendje parësore, sigurimin e cilësisë, ndaj operon për rritjen e saj në bashkëpunim me NJSBCZHK.

Në fillim të vitit akademik, NJSBCZHK ka paraqitur në Rektorat planveprimin e kësaj zyre, i cili është hartuar në bazë të politikave dhe strategjive institucionale për zhvillimin, përmirësimin dhe ruajtjen e standarteve. Planveprimi është hartuar në bazë të nevojave të institucionit për sigurimin e standarteve dhe cilësisë si dhe duke u bazuar, jkr tek gjetjet, apo nevojat për përmirësim që kanë dalë nga monitorimet e vitit të kaluar akademik.

Bazuar në kalendarin akademik 2021-2022, të miratuar nga Rektorati, në periudha të ndryshme të vitit akademik, njësia ka zhvilluar aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë të UMSH. Qëllimi i gjithë aktivitetit vjetor 2021-2022 është sigurimi i cilësisë dhe ruajtja e standarteve sipas udhëzimeve të ASCAL dhe sipas strategjisë së Institucionit. Njsbczhk ka si detyrë parësore që të ndjekë me rigorozitet planveprimin e miratuar nga Rektori. Ky planveprim është hartuar në drejtim të: mësimdhënies, mësimnxënies, ecurisë së procesit mësimor, marrëdhënies pedagog-student, si dhe marrëdhënies departament-student.

NJSBCZHK operon duke e bërë publike planveprimin e saj në fillim të vitit akademik, duke njoftuar paraprakisht përgjegjësën e departamentit për monitorimet sipas rastit dhe duke vënë gjithnjë në dijeni Rektoratin për fillimin dhe mbarimin e cdo aktiviteti. Në fund të cdo procesi, NJSBCZHK dorëzon në rektorat raport me shkrim. Gjithashtu në fund të cdo viti akademik dorëzon në Rektorat dosjen e plotë me raportet e nxjerra nga monitorimet. Në fund të vitit akademik kësaj dosjeje i bashkëngjitet dhe raporti vjetor i kësaj njësie.

C. VEPRIMTARITË E KRYERA DHE AKTIVITETET E VLERËSUARA NGA NJSBCZHK PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË UMSH

1. Në fillim të vitit akademik, anëtarët e NJSBCZHK kanë zhvilluar takimim e parë. Në këtë takim për këtë vit, anëtarët kanë diskutuar rreth realizimit dhe ndjekjes me rigorozitet të planveprimit të njësisë. Është vendosur mbi mënyrën e monitorimit dhe raportimit të çdo procesi, ku rëndësi të veçantë iu dha bashkëpunimit mes anëtarëve dhe njësive bazë të UMSH. Në proceset e vazhdueshme të kësaj njësie janë përfshirë të gjithë anëtarët e NJSBCZHK të caktuar në organigramën e miratuar.
2. Ndarja e detyrave për çdo anëtar të njësisë është bërë në mënyrë propocionale dhe transparente, ku të pranishëm në të gjitha proceset kanë qenë të gjithë anëtarët e NJSBCZHK.
3. Nën drejtimin e drejtueses së zyrës, anëtarët e NJSBCZHK kanë realizuar monitorimet apo vlerësimet për çdo aktivitet sipas rubrikave të planveprimit dhe në fund kanë patur detyrimin që të bëjnë raport me shkrim. Çdo anëtar i njësisë, dorëzon raport të veprimtarisë në formë elektronike dhe në hardcopy të firmosur pas çdo aktiviteti monitorues. Të gjitha monitorimet, vlerësimet dhe aktivitetet e kësaj njësie për vitin akademik 2021-2022 ruhen në dosje të veçantë në NJSBCZHK.
4. Para fillimit të çdo aktiviteti, NJSBCZHK ka zhvilluar takime konsultuese për mënyrën e vlerësimit si dhe për përdorimin e modelraporteve të përbashkët për të gjithë anëtarët. Në këtë mënyrë, të gjithë vlerësojnë dhe raportojnë sipas një gjuhe të përbashkët. Këto takime janë të zbardhura me procesverbale të vecanta, dhe u janë vënë në dispozicion Rektoratit me dorëzimin e dosjes në fund të vitit akademik.
5. NJSBCZHK ka operuar në mënyrë të pavarur për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të ndryshme dhe ka respektuar detajet e miratuara në planveprimin e miratuar nga Rektori. Me kërkesë të Rektoratit, ka kryer edhe veprime të tjera administrative sipas rastit dhe nevojave që ka patur Rektorati përgjatë zhvillimit të procesit mësimor të vitit akademik 2021-2022. Në të gjitha rastet Rektorati dhe Drejtuesit e njësive bazë janë vënë në dijeni me email përpara çdo fillimi të proceseve të ndryshme të punës së NJSBCZHK, duke kërkuar mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e tyre që çdo anëtar të marrë të dhënat e nevojshme sipas rastit që është vlerësuar.
6. **NJSBCZHK** është kujdesur përgjatë gjithë vitit akademik 2021-2022 që në SHARE FOLDER, UMSH Dokumentacione të hidhen të gjitha materialet e nevojshme për stafin akademik dhe administrativ, ku sipas nevojave apo proceseve të ndryshëm,

- individidët e lejuar aksesojnë materialet përkatëse. Dokumentave ekzistues u janë shtuar edhe dokumentat e këtij viti akademik, psh folderat e syllabuseve për cdo departament për të dy ciklet e studimit.
7. Në fillim të vitit akademik 2021-2022 NJSBCZHK, në kuadër të ruajtjes së nivelit të cilësisë në UMSH, të zhvillimeve në kuadrin ligjor si dhe garantimin nga ana e institucionit të nivelit të kërkuar për standartet e stafit akademik, Rektorati ka kërkuar organizimin e Trajnimit të të gjithë stafit akademik dhe atij administrativ, ku NJSBCZHK ka dhënë një kontribut të rëndësishëm.
 8. Duke u bazuar në planveprimin e vitit akademik 2021-2022, NJSBCZHK në bashkëpunim me drejtuesit e njësisë bazë ka ndërtuar dhe zhvilluar programin SEMESTRAL për monitorimin e zhvillimit të mesimit. Programi është hartuar duke pasur parasysh objektivat e departamenteve dhe të vetë njësisë. Në përfundim të procesit në të dy semestrat, planit të punës për monitorimin e zhvillimit të mesimit i janë bashkëngjitur edhe formularët e vlerësimeve për çdo pedagog. Sipas planit përkatës, në orën mësimore të caktuar ka pasur përfaqësues nga departamenti dhe përfaqësues nga NJSBCZHK. Të dy anëtarët kanë detyrimin e plotësimit dhe dorëzimit të formularit të vlerësimit për cdo pedagog dhe lëndë.
 9. Duke u bazuar në Kalendarin Akademik të UMSH për 2021-2022, NJSBCZHK ka mbajtur kontakte të rregullta me koordinatore të fakulteteve dhe sekretarinë në lidhje me njoftimet e studentëve për secilin proces akademik.
 10. Në këtë vit akademik, NJSBCZHK është bërë pjesë e ekipit për mirëmbajtjen e Faqes zyrtare të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, duke kontribuar në rishikimin e rubrikave për materialet që bëhen publike në këtë faqe.
 11. Për një funksionim sa më të drejtë dhe transparent të TUTORIATIT AKADEMIK, NJSBCZHK ka dhënë kontributin e saj për organizimin dhe dokumentimin e këtij procesi. Bazuar në organigramën e Zyrës së Këshillimit të studentëve dhe karrierës, NJSBCZHK ka kërkuar që pedagogët tutorë të vijnë të mbajnë hapur classroomet për takimet e tutorëve me studentët sipas programit të studimit në Bachelor. Qëllimi i kësaj kërkese, ka qenë që tutorët përveç takimeve në auditor të zhvillojnë edhe takime online sipas rastit. Gjithashtu këto classrome kanë shërbyer edhe si bllok njoftimesh

drejtuar studentëve për cdo aktivitet shkollor dhe aktivitet studentor që vjen nga departamenti, këshilli studentor dhe klubet studentore.

Kjo njësi ka monitoruar implementimin dhe respektimin e udhëzimit “Mbi autoritetin e tutorit në UMSH” duke monitoruar gjithë procesin e Tutoriatit që është zhvilluar përgjatë këtij viti akademik.

12. Për sa i përket cilësisë së mësimdhënies në UMSH, NJSBCZHK i ka kushtuar një rëndësi të vecantë edhe takimeve me Këshillin studentor, një herë në muaj me kalendar të vecantë, si dhe në ditë të tjera jashtë kalendarit, sipas kërkesave apo nevojave që ka patur Këshilli studentor gjatë vitit akademik 2021-2022. Të gjitha takimet me përfaqësuesit e studentëve kanë procesverbal takimi të veçantë. Këto takime kanë bërë të mundur krijimin e një elementi thelbësor për marrjen e reagimeve të drejtpërdrejta, pikëpamjeve dhe opinioneve nga studentët e UMSH si dhe përcjelljen e mendimeve, ideve apo vendimeve të institucionit tek studentët.
13. Si cdo vit, në kuadër të planveprimit të NJSBCZHK, janë realizuar edhe monitorimet e syllabuseve në UMSH Dokumentacione sipas folderave të departamenteve përkatës. Monitorimet e syllabuseve të miratuar janë kryer në fillim të çdo semestri. Grupet e punës janë ndarë në dy persona për secilin grup dhe kështu raporti i monitorimit mban firmën e dy anëtarëve të NJSBCZHK. Qëllimi i këtij monitorimi nga ana e NJSBCZHK ka qenë respektimi i formatit të programit të lëndës sipas VKM 879 si dhe përdorimi i literaturës së detyrueshme për cdo lëndë. Pas monitorimeve semestrale, NJSBCZHK i ka përcjell raportet në Rektorat dhe më tej është vijuar monitorimi për përmirësimin e ndonjë elementi të mundëshëm tek ndonjë lëndë. Kopje të raporteve gjenden edhe në dosjen e NJSBCZHK për vitin akademik 2021-2022.
14. Nisur nga përvoja e vitit të kaluar, krijimi i classroomeve ka rezultuar efektiv për dërgimin e leksioneve/ pyetjeve/ detyrave tek studentët. Si rrjedhojë NJSBCZHK ka sygjerruar që përkrah mësimin në auditor dhe dorëzimit të leksioneve në bibliotekë, pedagogët të krijojnë edhe classroome për cdo lëndë në semestër. Gjatë këtij viti akademik, NJSBCZHK ka monitoruar edhe hedhjen e temave, detyrave dhe leksioneve përkatëse në cdo lëndë.

D. ANALIZË E VEPRIMTARIVE TË KRYERA PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022.

NJSBCZHK ka identifikuar se krijimi i SHARE FOLDER me UMSH Dokumentacione si dhe pasurimi i tij me foldera të ndryshëm u ka dhënë mbështetje shumë proceseve akademike:

- Në çdo moment pedagogët, përgjegjësit e departamenteve dhe grupet e punës për RVB kanë aksesuar për nxjerrjen e rregulloreve, formateve, udhëzimeve etj; sigurisht sipas nevojave.
 1. Syllabuset e depozituara nga vetë drejtuesit e njësisë bazë në NJSBCZHK, për qëllimin e grumbullimit të tyre në SHARE Folder, pasi janë hedhur në të, kanë kaluar në proces monitorimi edhe për vitin akademik 2021-2022.
 2. Gjatë monitorimit të syllabuseve në të dy semestrat është vërejtur se një përqindje shumë e lartë e ka respektuar formatin me rigozitet. Për 2 lëndë që duhet të rishihej literatura e detyrueshme (të jetë e 5 viteve më të fundit), njësia ka raportuar dhe dy pedagogëve u është kërkuar rishikimi i syllabusit deri në një deadline të dytë, të caktuar nga Rektori.
- Në kuadër të përpjekjeve për përmirësimin e mëtejshëm të punës në drejtim të mësimdhënies, ruajtjes së standarteve dhe cilësisë, si dhe tërësisë të jetës studentore në UMSH, që në fillim të vitit akademik dhe deri në përfundim të tij, NJSBCZHK ka monitoruar takimet e studentëve me tutorët akademik, ku në të gjitha rastet ka qenë pjesë e njoftimeve për zhvillimin e tyre si dhe e pranishme. Të qenit prezent, në këto takime, ka bërë të mundur që njësia të marrë feedbackun e studentëve, të të gjitha programeve në lidhje me procese të ndryshme akademike të këtij viti. Pothuajse në të gjitha takimet është vënë re një prezencë e lartë e studentëve sipas programeve, megjithatë është kërkuar me këmbëngulje që prezenca në tutoriat sipas programit të jetë sa më masive, në mënyrë që të gjithë studentët të njihen me rregullat e institucionit dhe procedurat e zhvillimit të orës mësimore apo provimet.
- Po një herë në muaj, NJSBCZHK ka qenë prezente edhe në takimet me Këshillin studentor, nga i cili ka marrë shumë të dhëna mbi mbarëvajtjen e procesit mësimor, të

- cilat më pas i ka përcjell në Rektorat, sipas rastit dhe nevojës. (procesverbalet e takimeve me Këshillin studentor të dorëzuara në dosjen e NJSBCZHK për rektorat.
- Procesi i monitorimit të mësimin, sipas kalendarit të përcaktuar në bashkëpunim me drejtuesin e departamentit ka vijuar përgjatë gjithë vitit akademik. Kalendarit monitorues ka qenë semestral. Për cdo monitorim është realizuar raport vlerësimi dhe nga anëtari i NJSBCZHK si dhe dhe përgjegjësi i departamentit. Në të gjitha rastet, pedagogu është njoftuar paraprakisht për vizitën. Në vlerësimin e saj për cdo pedagog, Njësia ka shprehur mendimin e saj në raportin individual. Gjatë këtij viti akademik vlerësimet kanë rezultuar tepër të mira, përveç rastit të një pedagogu, të cilit i është tërhequr vëmendja për ta zhvilluar mësimin në formë më interaktive.
 - NJSBCZHK ka zhvilluar monitorimin e formatit të detyrës së kursit dhe si rrjedhojë, në mënyrë rastësore, me lejen e rektoratit ka vijuar monitorimin në classroomet e semestrit të dytë të vitit të kaluar të disa pedagogëve nga të tre fakultetet. Përgjithësisht të gjithë studentët kanë respektuar formatin e detyrës së kursit me hyrje, zhvillim përfundim, citime në tekst dhe bibliografi. Në një rast të caktuar, ku lënda është më shumë e karakterit praktik, nuk ishte respektuar formati dhe si rrjedhojë, pas raportimit të NJSBCZHK në rektorat, pedagogu në fjalë është thirrur dhe i është kërkuar që të respektojë formatin e kërkuar pavarësisht natyrës së lëndës.
 - Në të dy semestrat, përkatësisht në javën e 13-të të tyre është zhvilluar edhe vlerësimi i studentit për PEDAGOGUN dhe LËNDËN. Sipas pyetësorit të formuluar nga NJSBCZHK dhe të miratuar nga Rektorati, studentët kanë vlerësuar pedagogun dhe lëndën për cdo semestër. Vlerësimi i tyre ka mbetur anonim. Në fund të procesit në të dy semestrat, vlerësimet janë përpunuar dhe janë dorëzuar në Rektorat. Ky i fundit në të gjitha rastet, ia ka bërë me dije pedagogut vlerësimin që kanë studentët e këtij viti për të dhe për lëndën përkatëse. Një përqindje e vogël studentësh të një programi të caktuar është shprehur për mundësinë e rishikimit të një lënde që nuk buron nga departamenti, por që është e detyrueshme në kurrikulën e programit që ndjekin. Bëhet fjalë për një lëndë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike, e cila është lëndë e detyrueshme për fakultetin e Shkencave sociale, psikologjike dhe politike. Rektorati është vënë në dijeni nga NJSBCZHK dhe në bashkëpunim me departamentin nga ku buron lënda, janë marrë masa, që lënda të zhvillohet me kazuese që janë më afër

fushës së shkencave sociale. Në përfundim të këtij procesi janë dorëzuar raporte në rektorat, në formë elektronike si dhe në dosjen vjetore.

- Krahasimisht me vlerësimin e pedagogut dhe lëndës, po në javën e 13-të të dy semestrave janë zhvilluar edhe focus-grupet me studentët e të gjitha programeve të studimit në të dy ciklet e studimit. Është hartuar një plan pune për këtë proces, është marrë miratimi i Rektoratit për metodologjinë e tij dhe ka vijuar puna për realizimin e këtyre takimeve. Në këto takime, studentëve u është bërë me dije se respektohet etika, ruhet anonimati dhe se zhvillimi i këtyre takimeve në formë të drejtpërdrejtë ka si qëllim ruajtjen e standarteve dhe përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor në raste problematikash. Gjatë këtyre takimeve, NJSBCZHK është kujdesur që të marrë vlerësime reale të studentëve. Këta të fundit janë shprehur pozitiv për komunikimin me pedagogët e programit të studimit që ndjekin, përveç ndonjë rasti kur kanë patur pakënaqësi në komunikim me pedagogun. NJSBCZHK ka zbardhur këto takime dhe i ka dorëzuar në Rektorat.
- Vlen për t'u theksuar fakti se studentët kanë qenë tepër aktivë përgjatë takimeve dhe të gatshëm për shprehur mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët, lëndët dhe gjithë procesin mësimor. Procesverbalet e takimeve, me gjetjet përkatëse, ku mund të theksohet fakti që studentët u ndjenë të lirshëm të shprehnin kënaqësitë dhe pakënaqësitë në lidhje me stafin akademik dhe procesin mësimor. Gjithashtu u vu re një gadishmëri e studentëve të UMSH për të ruajtur standartet e larta të institucionit. Studentët vlerësuan në mënyrë të kënaqëshme rreth 90 % të pedagogëve, si dhe shprehën nevojat për përmirësim të një pakice pedagogësh, ku sipas tyre kjo pakicë duhet të punojë më shumë për të qenë më fleksibël dhe më pranë studentëve. Marrëdhëniet me stafin akademik dhe administrativ me studentët ishin mjaftueshëmrisht të mira edhe pse në kushte pandemie. Studentët e viti të parë nuk përjashtuan vështirësitë e fillimit deri sa u mësuan me statusin student. NJSBCZHK u sygjeroi shfrytëzimin e orëve të Tutoriatit akademik. Studentët theksuan disa herë se ndiheshin krenarë që kanë bërë zgjedhjen e duhur për sa i përket studimeve të tyre në UMSH dhe entuziast që programi i studimit që po ndjekin do t'i afrojë më shumë me tregun e punës. Anëtarët e njësisë kanë sensibilizuar studentët që të jenë sa më aktivë në jetën studentore

- Njësia ka kërkuar bashkëpunimin e përfaqësuesëve të studentëve për plotësimin me rigorozitet të formateve të dosjes së praktikës në sistemin Bachelor dhe Master; për pjesmarrje të lartë në takimet e tutoriatit si dhe sensibilizim të studentëve për të qenë sa më aktiv në jetën studentore. Në lidhje me këtë të fundit vlen të vlerësohet aktivizimi i lartë i studentëve në krijime dhe publikime të reflektimeve, shkrimeve në gazete dhe aktiviteteve që ka zhvilluar Këshilli studentor gjatë këtij viti akademik. Në të gjitha rastet NJSBCZHK ka kërkuar që studentët të shprehin lirshëm kërkesat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë që të merren masat e duhura nga Drejtimi për kapërcimet e tyre.

E. SUGJERIME:

Të depozituara në Rektorat,

UMSH, 25.07.2022

**Njësia e Sigurimit të Brendshëm,
të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, UMSH**